2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

it për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

15. Hapja e Ofertave

Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE**16. Konfidencialiteti**

Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruaj konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

17. Sqarimi i ofertave

Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave

1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE**19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik**

1. Për një pjesë të kriterëve të pranimi të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në

Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetëdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

20. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti

kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet/entet kontraktore

mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik

Nënkriteret⁴

i/a Përvoja për punë të ngjashme

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

(ii) Metodologjia e Propozuar

Nënkriteret

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia: Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përfaqjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojnë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përfaqjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

⁴ Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:

Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si

më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
Nëntor 2025	Grupi i punës	1	

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Miratoi: **Drejtuesi i Projektit**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Përgatiti:

**< Anëtarët e Grupit të Punës për Hartimin e Termave të Referencës,
mund të shtohen të tjerë>**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Person kontakti:

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Të dhënat e personit të Kontaktit:

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Adresa e-mail	
Nr. tel	

PËRMBAJTJA

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	Error! Bookmark not defined.
Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit	27
NËNSHKRIMET MIRATUESE	27
PËRMBAJTJA.....	28
1. HYRJE.....	30
1.1. Përfituesi / Autoriteti kon	30
1.2. Autoriteti Kontraktues	30
1.3. Historiku.....	30
1.4. Situata Aktuale në Sektor	Error! Bookmark not defined.
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	31
2.1. Objektivi i Përgjithshëm.....	31
2.2. Qëllimi.....	31
2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori	32
3. SUPOZIMET DHE RISQET	34
3.1. Supozimet e Projektit	Error! Bookmark not defined.
3.2. Risqet.....	Error! Bookmark not defined.
4. QËLLIMI I PUNËS	34
4.1. Të Përgjithshme.....	34
4.1.1. Përshkrimi i detyrës	34
4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet	35
4.1.3. Grupet e synuara	35
4.2. Puna specifike.....	37

5.	LOGJISTIKA DHE KOHA	39
5.1.	Vendndodhja	39
5.2.	Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave.....	39
6.	RAPORTIMI.....	39
6.1.	Kërkesat e Raportimin.....	39
6.2.	Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	Error! Bookmark not defined.
7.	KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA.....	40
8.	GARANCIA.....	41
9.	MIRËMBAJTJA	41
10.	PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT	44
11.	AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	44
12.	TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	44
13.	KËRKESAT FUNKSIONALE.....	45
13.1.	Kërkesa Funksionale.....	46
13.2.	Raporte.....	Error! Bookmark not defined.
14.	KËRKESAT TEKNIKE	48

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

1.2. Historiku

Sistemi e-Gate përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e proceseve të kalimit kufitar në Republikën e Shqipërisë, duke mundësuar verifikimin elektronik dhe të autorizuar të udhëtarëve nëpërmjet pajisjeve inteligjente të identifikimit biometrik.

Zgjidhja u implementua në Aeroportin Ndërkombëtarë të Rinasit, si pika e parë kufitare në Shqipëri që aplikon procesin e kontrollit të udhëtarëve në mënyrë tërësisht elektronike, pa ndërhyrje njerëzore.

Kjo nisem u realizua në kuader të modernizimit të infrastrukturës kufitare dhe rritjes së sigurisë kombëtare, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të rendit dhe agjencisë e menaxhimit të kufirit.

Vendosja e pajisjeve e-Gate synon të përshpejtojë procedurat e kalimit, të përmirësojë përvojën e udhëtarëve dhe të reduktojë ngarkesën operative të punonjësve të kufirit, duke ruajtur standartet më të larta të sigurisë dhe kontrollit të identitetit.

Pajisjet e instaluar në Rinas funksionojnë përmes verifikimit biometrik automatik, ku sistemi lexon të dhënat e pasaportës elektronike dhe kryen krahasimin e fotografisë së ruajtur në çip me fotografinë e marrë në kohe reale, për të konfirmuar identitetin e udhëtarit.

Procesi kryhet në mënyrë tërësisht lokale (on-premise), pa lidhje interneti dhe paruaftje të dhenave pas përfundimit të verifikimit, duke garantuar siguri maksimale dhe mbrojtje të privatesise.

Implementimi i kësaj zgjidhjeje shënoi një etapë të re në digjitalizimin e shërbimeve kufitare shqiptare, duke e pozicionuar Rinasin ndër pikat më moderne të kontrollit kufitare në rajon, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ICAO dhe BE për identifikimin biometrik të udhëtarëve.

Bazuar në përvojën e fituar nga implementimi e-Gate në Rinas, është planifikuar ndërtimi i një zgjidhjeje të re për pikat kufitare portuale, e cila do të ketë artitekturë dhe funksionalitete të përshtatura posaçërisht për fluket detare dhe për kushtet e veçanta të operimit në porte. Kjo

është një zgjidhje e re e cila merr modelin teknik dhe parimet e funksionimit nga përvoja e mëparshme e Rinasit, duke aplikuar teknologji të përditesuar dhe komponentët e rinj për identifikim biometrik, menaxhim hyrje-daljesh dhe siguri operative në mjediset portuale.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është projektimi, zhvillimi dhe implementimi i sistemit elektronik Border Controller, i cili do të mundësojë verifikimin e automatizuar të udhetareve në dy pika kufitare portuale të Republikës së Shqipërisë – Porti i Durrësit dhe Porti i Sarandës – me mundësi zgjerimi në të ardhmen në pikat e tjera kufitare detare apo tokësore.

Sistemi do të ndërtohet mbi teknologjinë moderne dhe arkititekturë të sigurtë, duke përdorur pajisje inteligjente për lexim dokumentash, kapje të imazheve në kohë reale dhe validim biometrik.

Ky projekt synon të sigurojë rritjen e sigurisë kufitare, lehtësimin e procedurave të kalimit dhe rritjen e efikasitetit operacional, duke garantuar integritet, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë kufitare dhe mbrojtjes së të dhënave.

2.2. Qëllimi

Qëllimet e kësaj kontrate janë si më poshtë:

- Ndërtimi i sistemit të ri Border Controller për automatizimin e verifikimit të udhëtarëve në Portin e Durrësit dhe Portin e Sarandës;
- Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve në dy pikat kufitare portuale të Republikës së Shqipërisë, në Portin e Durrësit dhe Portin e Sarandës.
- Zhvillimi i aplikacionit të sigurt që kryen verifikimin biometrik në mënyrë lokale (on-promise), pa lidhje interneti dhe pa ruajtjen e imazheve pas përfundimit të verifikimit;
- Integrimi i pajisjeve hardware (lexues dokumentesh, kamera, sensorë dhe mekanizma hyrje-dalje) me një aplikacion qendror për menaxhimin dhe kontrollin e proceseve;
- Integrimi me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit dhe platformat mbështetëse (TIMS, e-Visa, FER, Interpol etj.);
- Trajnimi i përdoruesve dhe administratorëve të sistemit;
- Sigurimi i shërbimeve të rinirëmbajtës preventive dhe korigjuese

Sistemi që do të ndërtohet dhe vihet në zbatim duhet të jetë në përputhje me vendimin nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e Rregullores për administrimin e sistemeve të bazave të të

dhënave shtetërore”, të ndryshuar, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave dhe sistemeve.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, me qëllim modernizimin e procedurave të kontrollit kufitar dhe rritjen e sigurisë në pikat portuale të Durrësit dhe Sarandës, synon ndërtimin e një sistemi të ri elektronik Border Controller që do të:

- Risë nivelin e sigurisë dhe besueshmërisë së verifikimeve kufitare;
- Lehtësojë procesot e regjistrimit dhe kalimit të udhëtarëve në mënyrë automatike;
- Risë saktësinë e të dhënave dhe parandalojë gabimet gjatë identifikimit;
- Sigurojë përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare për verifikimin biometric dhe sigurinë kombëtare;
- Përmirësojë përvojën e udhëtarëve dhe shpejtësinë e procesit të kontrollit kufitar.

Në këtë kuadër, kërkohet që:

- Të zhvillohet dhe vihet në funksion sistemi elektronik Automatic Border Controller (AßC) për verifikimin automatik të udhëtarëve nëpërmjet pajisjeve inteligjente që kryejnë leximin e pasaportave dhe kartave të identitetit biometrike, si dhe krahasimin e fotografisë së ruajtur në çip me fotografinë e marrë në kohë reale nga kamera e pajisjes.
 - Sistemi duhet të sigurojë përputhshmëri me standardet ICAO 9303 për leximin MRZ dhe RFID;
 - Sistemi duhet të ketë algoritëm të posatshe për përcaktimin e Radio-Frekuencave me fushë komunikimi të shkurtër.
 - Proçesi i verifikimit duhet të kryhet në mënyrë lokale (on-premise), pa lidhje interneti dhe pa ruajtjen e imazheve pas përfundimit të verifikimit;
 - Pajisjet lexuese duhet të jenë të certifikuara dhe të afta për përpunimin e të dhënave biometrike nga dokumentet elektronike të udhëtimit.
- Të integrohen pajisje për kapjen e imazhit të fytyrës dhe për krahasimin biometrik me nivel të lartë saktësie, duke përfshirë mekanizma të detektimit të pranisë reale (liveness detection).
 - Pajisjet duhet të jenë të afta të operojnë në kushte të ndryshme ndriçimi dhe ngarkese.
- Të zhvillohet moduli për integrimin e Automatic Border Controller me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit, përfshirë TIMS, e -Visa, FER, Interpol dhe sistemet e tjera të mbështetjes operative

-
- Integrimi duhet të mundësojë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale për verifikimin e vizave, lejeve të qëndrimit, apo rasteve të evidentuara në listat e kontrollit;
 - Komunikimi ndërmjet sistemeve duhet të realizohet përmes API-ve të sigurta, duke respektuar protokollet e sigurisë dhe standardet për enkriptim dhe autentifikim.
 - Të implementohen mekanizmat e kontrollit fizik të kalimit përmes dyerve automatike të lidhura me sistemin e verifikimit, në mënyrë që kalimi të lejohet vetëm pas përfundimit me sukses të procesit biometrik.
 - Pajisjet e kontrollit hyrje-dalje duhet të garantojnë siguri fizike, funksionim të qëndrueshëm dhe të jenë të përshtatura për mjediset portuale.
 - Të krijohet moduli i monitorimit dhe raportimit që do të mundësojë:
 - Gjenerimin e raporteve operative dhe statistikave për flukset e udhëtarëve;
 - Auditimin e çdo veprimi të sistemit për qëllime sigurie dhe gjurmueshmërie;
 - Monitorimin në kohë reale të funksionimit të pajisjeve dhe njoftimin automatik në rast anomalie.
 - Pajisjet të mund të konfigurohen për të pritur një kategori të caktuar, p.sh për menaxhimin e ekuipazheve të mjeteve lundruese që hyjnë dhe dalin nga portet, në bashkërendim me të dhënat e regjistrimit detar të portit të Durrësit, për të mundësuar regjistrim të automatizuar dhe kontroll të saktë të lëvizjeve.
 - Të sigurohet ndërtimi i sistemit mbi arkitekturë modulare, me mundësi zgjerimi në të ardhmen në pika të tjera kufitare dhe me aftësi për integrim me pajisje të ndryshme që respektojnë standardet e përbashkëta të komunikimit.

Rezultatet e pritshme që duhet të arrijë kontraktori, pa u kufizuar në to, janë si më poshtë:

- Ndërtimi dhe funksionalizimi i plotë i sistemit Border Controller në portet e Durrësit dhe Sarandës;
- Levrimi, instalimi dhe konfigurimi i të gjitha pajisjeve harduerike dhe komponentëve përkatës (lexues dokumentesh, kamera, pajisje biometrike, njësi kontrolli hyrje-dalje, infrastrukturë rrjeti dhe energjie), sipas kërkesave teknike të specifikuara në këto Terma Reference;
- Implementimi i të gjitha komponentëve softuerikë në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë;
- Integrimi me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit dhe platformat mbështetëse ekzistuese;
- Kryerja e testimeve funksionale dhe pranimi teknik i sistemit nga autoriteti përfitues;
- Trajnimi i përdoruesve dhe administratorëve të sistemit për përdorim dhe mirëmbajtje;
- Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes preventive dhe korrigjuese;
- Sigurimi i dokumentacionit teknik, manualeve të përdorimit dhe raporteve të testimit;
- Dorëzimi përfundimtar i sistemit dhe i pajisjeve në gjendje plotësisht funksionale, në përputhje me kërkesat e specifikuara në këto Terma Reference.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti.
- Stafi i autoriteti kontraktues, përfituesit dhe operatorit ekonomik fitues duhet të jenë komunikues dhe bashkëpunues me njëri tjetrin;
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti.
- Angazhim dhe mbështetje e plotë nga të gjithë palët e tjera të përfshirë në këtë projekt;

3.2. Rrisqet

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos kordinimit të punës mes pjesëtarëve të përfshirë në këtë proces.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik fitues në projekte të tilla.
- Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit;
- Mungesa e dokumentimit të mirë të sistemit.
- Përdorimi i teknologjive dhe standarteve komerciale të cilat janë të njohura nga sulmuesit e mundshëm.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- Ligji Nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji Nr. 71/2016 PËR KONTROLLIN KUFITAR (ndryshuar me ligjin nr. 22/2020, datën 5.3.2020)
- Ligji 79/2021 “Për të huajt”;
- VKM nr.858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 112, date 24.02.2025 “Per Miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”;

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Projekti përfshin ndërtimin dhe vendosjen në funksion të sistemit elektronik Automatic Border Controller në portet e Durrësit dhe Sarandës, për automatizimin e proceseve të verifikimit të udhëtarëve gjatë hyrje-daljeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Zgjidhja do të integrojë pajisje inteligjente për leximin e dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimin biometrik të personave, duke siguruar shpejtësi, saktësi dhe standarde të larta sigurie.

Projekti parashikon gjithashtu zhvillimin e platformës softuerike, integrimin me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit (TIMS, e-Visa, FER, Interpol etj.), testimin funksional të të gjitha proceseve dhe trajnimin e përdoruesve për përdorim efektiv të sistemit. Pas përfundimit të implementimit dhe pranimit teknik, kontraktori do të garantojë mirëmbajtjen e sistemit dhe funksionimin e tij të pandërprerë për një periudhë dyvjeçare, duke siguruar disponueshmëri të lartë dhe mbështetje të vazhdueshme teknike për strukturat përfituese.

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqipërisë

4.1.3. Grupet e synuara

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
2. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;

4.1.4. Siguria e sistemit

Sistemi Automatic Border Controller duhet të jetë i qëndrueshëm, i besueshëm dhe të garantojë në çdo moment integritetin dhe plotësinë e informacionit, duke qenë i mbrojtur ndaj çdo forme ndërhyrjeje të paautorizuar. Ai duhet të ndërtohet mbi parime të sigurisë shumë-shtresore, duke përfshirë masat fizike të sigurisë së pajisjeve, sigurinë logjike të aplikacionit, enkriptimin e komunikimit dhe kontrollin e aksesit në të gjitha nivelet e përdorimit.

Sistemi duhet të lejojë akses vetëm për personat e autorizuar dhe të ofrojë mundësinë e përcaktimit të të drejtave të përdoruesve në nivel roli, moduli dhe funksioni, në përputhje me strukturën institucionale të përdoruesve. Të drejtat e aksesit (lexim, modifikim, ekzekutim dhe fshirje) duhet të menaxhohen nga administratori i sistemit dhe të jenë të përcaktuara qartë për secilin përdorues. Çdo përdorues do të identifikohet në sistem përmes kredencialeve të veta unike dhe do të ketë qasje vetëm në funksionalitetet që i korrespondojnë rolit të tij funksional.

Ndërfaqja e sistemit duhet të jetë web-based dhe të aksesohet vetëm nga përdoruesit e autorizuar të institucioneve përmes llogarive të dedikuara dhe protokolleve të sigurta. Procesi i regjistrimit të përdoruesve do të kryhet nga administratori i sistemit (ose persona të autorizuar nga ai), me kërkesë zyrtare nga institucioni përkatës ku përdoruesi është i punësuar. Administratori duhet të ketë mundësi të menaxhojë në çdo kohë krijimin, pezullimin dhe mbylljen e llogarive të përdoruesve, në përputhje me ndryshimet organizative dhe nevojat e aksesit.

Sistemi duhet të sigurojë funksionalitete të avancuara auditimi dhe monitorimi të veprimeve, duke regjistruar në mënyrë automatike çdo hyrje, dalje dhe operacion të kryer nga përdoruesit, përfshirë kërkimet, modifikimet, shtimet dhe fshirjet e të dhënave. Historiku i aktiviteteve duhet të ruhet në mënyrë të qëndrueshme dhe të jetë i aksesueshëm vetëm nga administratori ose rolet e autorizuar për kontroll dhe auditim.

Për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen nga qasjet e paautorizuara, baza e të dhënave të sistemit duhet të jetë e enkriptuar sipas standardit AES (Advanced Encryption Standard) 256-bit. Enkriptimi duhet të zbatohet si në nivel të ruajtjes së të dhënave (data-at-rest) ashtu edhe gjatë komunikimit me përdoruesit (data-in-transit). Të gjitha lidhjet ndërmjet komponentëve të sistemit duhet të përdorin protokolle të sigurta komunikimi, si HTTPS/TLS.

Pajisjet fizike të sistemit Automatic Border Controller, përfshirë serverët, lexuesit e dokumenteve, kamerat biometrike dhe njësitë e kontrollit të hyrje-daljeve, duhet të jenë të mbrojtur nga ndërhyrjet fizike të paautorizuara dhe të pajisura me mekanizma sigurie kundër manipulimeve (tamper detection). Çdo komponent që përpunon të dhëna biometrike duhet të sigurojë mbrojtje të nivelit të lartë gjatë përpunimit dhe transmetimit të këtyre të dhënave.

Sistemi duhet të ofrojë masa por vazhdimësinë e funksionimit dhe rikuperimin në rast ndërprerjesh, duke përfshirë kopjet rezervë të të dhënave, procedurat e rikthimit në funksionim dhe testimin periodik të këtyre mekanizmave nga administratori.

Sistemi Automatic Border Controller duhet të projektohet, zhvillohet dhe operojë në përputhje të plotë me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe identifikimit biometrik.

Zgjidhja duhet të garantojë respektimin e kërkesave të përcaktuara në:

- **ISO/IEC 27001** — për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe implementimin e kontroleve të brendshme për mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave;
- **GDPR (Regullorja e BE 2016/679)** — për mbrojtjen e të dhënave personale dhe biometrike të udhëtarëve, duke siguruar përpunimin e drejtë, ligjor dhe proporcional të informacionit;

Të gjithë komponentët harduerikë dhe softuerikë që do të përdoren në sistem duhet të jenë të certifikuar nga prodhuesi dhe të përputhshëm me standardet përkatëse ndërkombëtare. Çdo element që përpunon ose transmeton të dhëna biometrike duhet të sigurojë mekanizma mbrojtjeje ndaj aksesit të paautorizuar dhe manipulimit.

Në çdo fazë të zbatimit dhe operimit, sistemi Automatic Border Controller duhet të sigurojë gjurmueshmëri të plotë të veprimeve, mbrojtje të integritetit të informacionit dhe kontroll të vazhdueshëm të parametrave të sigurisë, në mënyrë që të garantojë përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë.

4.2. Detyrat specifike

Zbatimi i projektit Automatic Border Controller do të ndahet në fazat e mëposhtme:

FAZA I: Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proceseve

- Analiza e plotë e të gjitha procedurave operative, ligjore dhe teknike që lidhen me procesin e verifikimit të udhëtarëve në portet e Durrësit dhe Sarandës;
- Analizë e të dhënave që mund të merren me ndërveprim nga regjistrat elektronikë apo sistemet e tjera të Policisë së Shtetit dhe institucioneve partnere për automatizimin e proceseve të kontrollit kufitar;
- Identifikimi i flukseve të punës dhe pikave të integritetit që do të jenë objekt i sistemit Automatic Border Controller;
- Përgatitja e dokumentit të kërkesave funksionale dhe teknike (Functional and Technical Requirements Document) që do të shërbejë si bazë për projektimin e zgjidhjes.

FAZA II: Levrimi dhe instalimi i pajisjeve

Kjo fazë përfshin levrimin, instalimin dhe konfigurimin fillestar të të gjitha pajisjeve harduerike që do të përdoren për ndërtimin e sistemit Automatic Border Controller.

- Levrimi i pajisjeve në portet e Durrësit dhe Sarandës sipas listës teknike të miratuar nga autoriteti përfitues;
- Verifikimi i parametrave teknikë të pajisjeve për përputhshmëri me kërkesat e specifikuara në Termat e Referencës;
- Instalimi fizik i pajisjeve. përfshirë portat elektronike të kontrollit, lexuesit e dokumenteve MRZ/RFID, kamerat biometrike, sensorët, njësitë e kontrollit hyrje-dalje, serverët, pajisjet e rrjetit dhe energjisë;
- Konfigurimi i pajisjeve dhe lidhja e tyre me rrjetin lokal dhe infrastrukturën ekzistuese të Policisë së Shtetit;
- Testimi fillestar i funksionalitetit bazë të çdo pajisjeje për të siguruar që operon sipas parametrave të kërkuar;
- Dokumentimi teknik i instalimeve dhe hartimi i skemave fizike të lidhjeve dhe konfigurimeve;
- Dorëzimi i pajisjeve të instaluara dhe funksionale për fazën e zhvillimit dhe integritetit të sistemit.

FAZA III: Zhvillimi dhe integrimi i sistemit Border Controller

Brenda objektit të punës së kësaj faze, Operatori Ekonomik duhet të ndërtojë dhe integrojë sistemin, duke:

- Projektuar dhe zhvilluar aplikacionin Automatic Border Controller për menaxhimin e proceseve të verifikimit të udhëtarëve;
- Integruar pajisjet e instaluar me sistemin softuerik për verifikimin biometrik dhe dokumentar;
- Zhvilluar komponentët për leximin, verifikimin dhe krahasimin e të dhënave të pasaportave biometrik në përputhje me standardin ICAO 9303, sipas shteteve që aplikohet.
- Realizuar integrimin e sistemit Automatic Border Controller me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit dhe platformat mbështetëse ekzistuese, përfshirë TIMS, e-Visa, FER dhe Interpol;
- Zhvilluar modulën e auditimit dhe raportimit për gjurmueshmëri të plotë të veprimeve dhe aksesit;
- Testuar funksionalitetet kryesore të sistemit në mjedis testimi (sandbox) përpara aktivizimit në prodhim.

FAZA IV: Testimi, trajnimi dhe dokumentacioni

Testimi

- Kryerja e testimeve funksionale, të performancës dhe sigurisë për verifikimin e qëndrueshmërisë së sistemit;
- Testimi i integritetit midis pajisjeve harduerike dhe komponentëve softuerikë;
- Kryerja e testimeve të pranimit (User Acceptance Testing) në prani të autoritetit përfitues;
- Dokumentimi i rezultateve të testimit dhe certifikimi i funksionalitetit për çdo modul dhe pajisje.

Trajnimi i përdoruesve

- Realizimi i trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe administratorët teknikë të sistemit;
- Ofrimi i trajnimeve të tipit “Training of Trainers” për strukturat qendrore dhe rajonale të Policisë së Shtetit;
- Trajnimi teknik për administrimin e sistemit, backup/restore, monitorimin e performancës dhe procedurat e mirëmbajtjes.

Dokumentacioni

- Dorëzimi i dokumentacionit teknik të plotë, përfshirë manualët e përdoruesit, dokumentet e konfigurimit, arkitekturën e sistemit dhe raportet e testimit;
- Marrja në dorëzim e sistemit dhe pajisjeve do të kryhet vetëm pas konfirmimit zyrtar të funksionalitetit dhe plotësisë së tyre nga autoriteti përfitues.

FAZA V: Mirëmbajtja

- Operatori ekonomik do të sigurojë mirëmbajtjen e sistemit dhe të gjithë komponentëve të tij për një periudhë dy vjeçare;
- Mirëmbajtja do të përfshijë mbikëqyrjen e funksionimit, përditësimet softuerike, asistencën teknike dhe zëvendësimin e pajisjeve që dalin jashtë funksioni;
- Do të zbatohen politikat e vazhdimësisë së punës dhe rikuperimit nga fatkeqësitë në përputhje me VKM nr. 710, datë 21.07.2013, të ndryshuar;

-
- Çdo veprim mirëmbajtjeje dhe incident teknik duhet të regjistrohet dhe raportohet periodikisht tek autoriteti përfitues.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Sistemi do të hostohet në infrastrukturën fizike qendrore të Policisë së Shtetit.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë dhe 2 vjet mirëmbajtja.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në original dhe 2 (dy) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 20 faqesh duhet të prodhohet brenda 5 (pesë) ditësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej 30 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranura nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Gjithashtu, operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë dhe raporte, si për shembull:

- 1- Raport instalimi.

-
- 2- Raport i arkitekturës SË i sistemit.
 - 3- Etj

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet të dorëzohet grupit të punës për ndjekjen e kontrates të identifikuar në kontratë.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemi duhet të jetë në gjendje të ekspozojë të dhëna në përputhje me standardet e përdorura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway) nëpërmjet ESB-se (Enterprise Service Bus) si dhe të mund të presë të dhëna të sistemeve të tjera elektronike kur ato mundësohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

Proçesi i verifikimit të pasagjerit dhe kalimi i tij kufitar kalon në disa hapa të rëndësishëm duke bërë kërkesa të shumta në disa databaza apo institucione të rëndësishëm.

Informacioni që trajtohet në këtë proçes përfshinë:

- Kontroll biometrik të dokumentit
- Kontroll të të dhënave në sistemet e mëposhtme në bazë të gjeneraliteteve dhe numrit identifikues të udhetarit:
 - o Identitek (gjeneralitete)
 - o Personat në Kërkim
 - o Flete arresti
 - o Njoftimet në kufi
 - o Dosjet kriminale
 - o TIMS për historikun e hyrje-daljeve
 - o TIMS për listen e Deportimeve/INAD, të Kthye, Dyshuar, Prapsuar etj
 - o Interpol
 - o WISDM
 - o Lista e Terroristeve nga FBI
 - o Sistemi FER për Lejet e Qëndrimit
 - o Sistemi eVisa për vizat
 - o ATSG
- Disa nga me sipër janë alerte të heshtura, pra informacioni që do të përpunohet është jashtëzakonisht i rëndësishëm me klasifikime të niveleve të larta.

Pajisjet egate do të instalohen në pikën kufitare dhe janë pika “ndarëse” e territorit shqiptarë me pjesën tjetër. Mosfunksionimi siç duhet ose manipulimi i saj do të cënonte sovranitetin e vendit tonë dhe cenim të sigurisë kombëtare.

- Teknologjitë e komunikimit

-
- Frekuencat e pajisjeve
 - Modelet dhe teknikat e programimit
 - Prodhuesit e komponenteve të ndryshëm
 - Etj
 - Të gjitha këto duhet të qëndrojnë të fshehta nga informimi publik past do të ishin të ekspozuara për studim të vulnerabiliteteve të aktorevë dashakeqës.
 - Nëse psh një “Këqdashës” do të ishte në dijeni të frekuencave që përdor skaneri, mund të afrohet me pajisje të tjetra që transmetojnë freuenca të shkurtera dhe të manipulonte leximin e dokumentit. Po ashtu, nëse zbulohen teknikat dhe algoritmet e komunikimit, është më e lehtë për të gjetur pika të dobëta. Pseudo-kodi apo workflow duhet të jetë gjithashtu sekret për mos të bërë të mundur ndërhyrjen në fazat e procesit të validimit.
 - Këshillohen operatorët të mos përdorin teknika komerciale, apo procedure standarte të autentifikimit, transformimit të të dhënave. Duke qenë se pajisjet operojnë të pavarura, të monitoruara në distancë nga prania njerëzore, mundësia e manipulimit rritet ndjeshëm, dhe çdo informacion i bërë publik për “Këqdashësin” është një cenim serioz i sigurisë.

Webservice-t që do të zhvillohen për realizimin e këtyre ndërveprimeve do të jenë pjesë e fazës së analizës, duke definuar fushat nga secila databazë.

Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë/përmirësojë/optimizojë dhe ndërveprime me sisteme të tjerë, të cilat mund të diskutohen gjatë fazës së analizimit, gjatë përmirësimit të sistemit apo gjatë procesit të mirëmbajtjes, si pasojë e ndryshimeve ligjore, sikurse përcaktuar dhe më sipër.

8. GARANCIA

E pa aplikueshme.

9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, të ndryshuar.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave recuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Diel, 24/7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “ Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje ëeb të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej 2 (dy) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjëndjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollesh si më:

1. Javore
 - a. Kontroll logesh.
 - b. Kontroll i statistikave të hapësirave server/storage
 - c. Kontroll i statistikave për sistemin.
 - d. Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirëmbajtje parandaluese dhe parashikuese)
 - e. Kontroll i funksionalitetit të sistemit
 - f. Ndërhyrje për zgjidhjen e problemeve, të verifikuara gjatë kontrolleve rutinë të monitorimit, apo të raportuara nga stafi i përcaktuar për ndjekjen e kontratës.
2. Mujore.

- Kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare.
- Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
- Ndërhyrje për zgjidhjen e problemeve, të verifikuara gjatë kontrolleve rutinë të monitorimit, apo të raportuara nga stafi i përcaktuar për ndjekjen e kontratës.
- Etj

Kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes:

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë periudhës së mirëmbajtjes

Kategoria A (Kritike/I Larte)	Kategoria A (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimale Aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mosfunksionim i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mosfunksionim i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve (2-5%)	Mosfunksionim i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues (<2%)
Pezullimi i punës		
Mosfunksionim i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mosfunksionim i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre.	Mosfunksionim i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre.
Zgjidhje alternative e përkohshme		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 30 min. Oër të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 2 orë	○ 30 min. Oër të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 2 orë	○ 60 min. për të kthyer përgjigje ○ Në vend brenda 4 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Zhvillimi dhe integrimi i sistemit Automatic Border Controller	1		
2.	Levrimi i paisjeve Border Controller	9		
3.	Instalimi dhe konfigurimi i paisjeve	1		
4.	Trajnimi i përdoruesve	1		
5.	Mirëmbajtja në vite	2		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7-M31
1	Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proçeseve	x	x					
2	Lëvrimi dhe instalimi i pajisjeve		x	x				
3	Zhvillimi dhe integrimi i sistemit Automatic Border Controller		x	x	x	x	x	
4	Testimi					x	x	
5	Trajnimi i përdoruesve						x	
6	Mirëmbajtja							x

12. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të sistemit apo pajisjeve, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor dhe Institucionit Përfitues. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar për çdo modul dhe për sistemin në tërësi, së bashku me setin e dokumentacionit teknik. Kodi burim duhet të dorëzohet i plotë pas implementimit të sistemit dhe i përditësuar sa herë që mund të bëhen ndryshime gjatë fazës së mirëmbajtjes, në fund të kësaj periudhe.

13. KËRKESAT FUNKSIONALE

Zgjidhja Automatik Border Controller (eGate) duhet të mundësojë verifikimin automatik të udhëtarëve gjatë hyrjes dhe daljes në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përdorur pajisje inteligjente për lexim dokumentesh, verifikim biometrik dhe menaxhim të kontrollit fizik të hyrje-daljeve. Sistemi do të implementohet në portet e Durrësit dhe Sarandës, me mundësi zgjerimi në pika të tjera kufitare në të ardhmen.

Proçesi i punës duhet të përbëhet nga dy faza funksionale të integruara:

Faza 1 — Kontrolli dokumentar (Gate 1)

Sistemi duhet të mundësojë leximin automatik të dokumentit të udhëtimit (pasaportë ose kartë identiteti biometrike) përmes zonës MRZ, duke marrë të dhënat e çipit përkatës. Të dhënat që lexohen duhet të përfshijnë: emrin, mbiemrin, moshën, gjininë (nëse përfshihet), datën e lëshimit, llojin dhe numrin e dokumentit, si dhe fotografinë biometrike.

Zgjidhja duhet të kryejë verifikimin e autenticitetit të dokumentit në përputhje me protokollet ndërkombëtare BAC, PACE dhe EAC (Active dhe Passive Authentication).

Pas leximit të të dhënave, ato duhet të dërgohen në sistemin qendror të Policisë së Shtetit për verifikimin e çdo sinjalizimi apo alerti të mundshëm, të lidhur me dokumentin ose mbajtësin e tij. Në varësi të përgjigjes nga sistemi, Gate 1 duhet të hapet dhe udhëtari të lejohet të vazhdojë, ose të qëndrojë e mbyllur dhe udhëtari të drejtohet në kontroll fizik.

Faza 2 — Verifikimi biometrik (Gate 2)

Sistemi duhet të mundësojë detektimin që në hapësirën midis dy dyerve të ndodhet vetëm një person. Nëse zbulohen më shumë se një individ, Gate 1 nuk duhet të mbyllet dhe duhet të aktivizohet alarm për njoftimin e stafit.

Më pas, Gate 2 duhet të kryejë skanimin biometrik të fytyrës në kohë reale dhe ta krahasojë me fotografinë biometrike të lexuar nga dokumenti në fazën e parë. Ky proçes duhet të realizohet plotësisht në mënyrë lokale (on-premise), pa ruajtje apo shpërndarje të të dhënave në cloud ose tek palë të paautorizuara.

Në rast përputhjeje, Gate 2 duhet të hapet dhe udhëtari të lejohet të kalojë. Në rast mospërputhjeje ose pasigurie në krahasim, Gate 1 duhet të hapet dhe udhëtari të ridrejtohet për kontroll fizik nga stafi kufitar.

Karakteristikat funksionale dhe teknike të zgjidhjes:

Proçesi i verifikimit duhet të kryhet tërësisht on-premise, në një mjedis rrjeti të mbyllur dhe të sigurt;

Sistemi nuk duhet të ruajë asnjë imazh apo të dhënë biometrike pas përfundimit të proçesit;

Zgjidhja duhet të mbështesë protokollet ndërkombëtare për autentikimin e dokumenteve biometrike (BAC, PACE EAC);

Të gjitha komunikimet ndërmjet pajisjeve dhe sistemit qendror duhet të jenë të enkriptuara dhe të sigurta;

Duhet të ofrohet SDK (Softëare Development Kit) dhe dokumentacion teknik për integrimin me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit (TIMS, e-Visa, FER, Interpol);

Sistemi duhet të jetë i shkallëzueshëm, me mundësi zgjerimi në pika të tjera kufitare, pa ndryshime thelbësore në arkitekturën ekzistuese.

Kjo zgjidhje duhet të mundësojë rritjen e nivelit të sigurisë kufitare, shpejtësinë e procesimit të udhëtarëve dhe reduktimin e ndërhyrjes njerëzore, duke siguruar një proces të automatizuar, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale dhe dokumenteve biometrike.

13.1. Funksionalitete dhe Bllokskema

Sistemi i përmiresuar duhet të jetë i përbërë nga module, por nuk do të jetë i kufizuar vetëm në modulet e përmendur në këto terma. Kjo do të thotë që sistemi duhet të lejojë shtimin e moduleve të tjera në bazë të ndryshimeve ligjore apo përmirësimeve të nevojshme në sistem që shikohen të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Përfituesin e Shërbimit.

Sistemi duhet të jetë një platforme e unifikuar që të funksionojë nga te gjitha postet e punës për çdo DVKM apo edhe në nivel qendror, duke ofruar funksionimin e saj në një mënyrë homogjene.

- Unifikimi i regjistrimit të qytetarit sipas:
 - Date/ore së dalje-daljes
 - Pika e kalimit kufitar
 - Dokumenti i udhëtimit
 - Informacione të tjera
- Rregjistrimi
 - Leximi i dokumentacionit nëpërmjet pajisjeve
 - Validimi i të dhënave biometrike
 - Validimi i të dhënave me palë të treta
 - Alert sinjalizues në kohë reale mbi qytetarin
 - Njoftuese
 - Parandaluese
 - Ndaluese
 - Informim në kohë reale mbi
 - Historikun
 - Lejet
 - Vizat
 - Shkeljet
 - Parregullsitë

-
- Krijimi i ndërfaqeve të veçanta mbi alertet
 - Ndërtimi i alerteve të veçanta që vinë nga sisteme të treta , verifikuese, ndaluese, historike
 - Ndërtimi i raportimeve
 - Ndërtimi i raporteve të veçanta në kohë reale
 - Ndërtimi i raporteve statistikore
 - Ndërtimi i raporteve njoftuese mbi rrezikshmërinë potenciale
 - Ndërtimi i raporteve sipas DVKM përkatëse që përdorin paisjet digjitale
 - Ndërtimi i raporteve dinamike të ndryshuara sipas kushteve mbi sigurinë dhe politikat vendimarrëse
 - Sistemi duhet të gjenerojë raporte, ditore, javore, mujore sipas kërkesave të përfituesit.

Operatori ekonomik fitues duhet të mundësojë dhe raporte të tjera të nevojshme, sipas kërkesave të AKSHI-t/përfituesit gjatë fazës së analizimit, gjatë procesit të ndërtimit apo më vonë gjatë mirëmbajtjes, pa kosto shtesë.

Workflow

- Pasagjeri paraqitet përpara pajisjes eGate dhe informohet nëpërmjet monitorit të jashtëm në pajisje që është gati për të skanuar pasaportën.
- Pasagjeri vendos pasaportën në skaner .
- Skaneri validon dokumentin në bazë të të dhënave MRZ-CHIP-VIZ.
- Skaneri dërgon të dhënat e dokumentit se bashku me rezultatin e verifikimeve në sistemin backend.
- Sistemi backend bën një kontroll paraprak nëse dokumenti është nga shtetet e lejuara për të përdorur egate, nëse pasagjeri është mbi 16 vjeç etj.
- Nëse kontrolli paraprak rezulton i suksesshëm, atëherë dera e parë hapet dhe në monitor udhëzohet pasagjeri për tu futur brenda në egate.
- Nëse kontrolli paraprak rezulton që ky pasagjar nuk plotëson kushtet për përdorimin e eGate, atëherë në monitor shfaqet mezashi për të udhëzuar pasagjerin të kalojë në kontrollin manual.
- Nëse rezultati i validimit të dokumentit nga skaneri ka qenë negativ, përsëri pasagjeri do të udhëzohet të hyjë brenda në egate, por në këtë rast egate do të bllokohet dyert dhe do të njoftohet Monitoruesi për të ndërmare veprimet e mëtejshme.
- Në rastin që dokumenti është validuar dhe pasagjerit i është lejuar të përdori eGaten, atëherë backend fillon kontrollin e thelluar të pasagjerit në listat kriminale.
- Në të njëjtën kohë pajisje egate kryen verifikimin e fytyrës së kapur nga kamera me fotot e marra nga skanimi i dokumentit.
- Nëse njëra nga kontrollet Verifikim Fytyre ose Kontroll Criminal rezulton me

probleme, atëherë pajisja bllokoi dyert dhe njoftohet Monitoruesi për të vazhduar me veprimet e mëtejshme.

- Nëse të dy kontrollet janë të suksesshme atëherë hapet dera e dytë dhe pasagjeri njoftohet për të dalë nga eGate.
- EGate njofton backend për kalimin me sukses të pasagjerit.
- Në rastet kur pasagjeri udhëzohet për tu futur brenda në kabinë dhe për një farë kohe ai nuk futet, eGate mbyll dyert dhe kthehet në gjëndjen fillestare.
- Në rast se pasagjeri udhëzohet për të dalë nga dera e dytë dhe ai nuk del për një farë kohe, atëherë dyert bllokohen dhe njoftohet Monitoruesi.
- Nëse gjatë procesimit të një pasagjeri, sensorët identifikojnë se pasagjeri ka kapercyer jashtë pajisjes, atëherë njoftohet Monitoruesi.
- Nëse pasagjeri është udhëzuar të dali nga kabina, pasagjeri del por ka harruar bagazhet mbrapa, atëherë dera qëndron e hapur për një farë kohe dhe pastaj bllokohet duke sinjalizuar Monitoruesin.

14. KËRKESAT TEKNIKE

• Pajisjet fizike e-Gate

- Pajisja duhet të jetë në formë kioske të pa mbuluar, pra udhëtari të ketë mundësinë të futet brenda.
- Duhet të jenë të pajisura me dy porta, hyrese dhe dalëse, të pajisura me sensore ndaj ushtrimit të forcës dhe me mekanizëm kundër përplasjeve dhe me sensore për të parandaluar mbylljen e dyerve mbi udhëtarin.
- Materiali i pajisjes duhet të jetë metalik i fortë, me boje rezistente ndaj korrozionit dhe veprimeve vandale me kategorizim të paktën IP54.
- Duhet të jenë të pajisur me UPS të integruar me fuqi për të paktën (20 min).
- Pajisja duhet të ketë monitor për udhëzimin e udhëtarit si brenda edhe jashtë pajisjes.
- Pajisja duhet të ketë kamerë për identifikimin e fytyrës me rezolucion të paktën 5Mb.
- Pajisja duhet të ketë kamerë 360 gradë për monitorim në kohë reale.
- Pajisja duhet të jetë e pajisur me sensore për detektimin e pranisë të një apo disa udhëtarëve njëkohsisht.
- Pajisje duhet të jetë e pajisur me ndriçues LED për të sinjalizuar gjëndje të ndryshme të procesit të kontrollit.
- Pajisja duhet të ketë skaner për leximin e dokumentit të udhëtimit.
- Skaneri duhet të lexojë MRZ me 2 apo 3 rrjeshta.
- Të lexojë chip-in e dokumentit biometrik me anë të RFID/NFC.
- Të lexojë të dhënat vizuale të printuara mbi dokument.
- Skaneri duhet të performojë leximet në format UV, IR, VIZ.
- Skaneri duhet të veprojë edhe në kushte me ndriçim të dobët.

• Software i pajisjes

- Pajisja duhet të ketë sistem operimi (Windows/Linux) të versionit të fundit dhe të liçensuar.

-
- Sistemi operativ duhet të jetë në gjëndje të adaptojë përditesimet e fundit (Patch) mbi sigurinë dhe performancën.
 - Duhet të ofrojë Secure Boot dhe të ekriptoje particionet ku operon software.
 - Software i pajisjes duhet të ofrojë lexim të zonës MRZ, të chip-it të dokumentit biometrik me anë të RFID/NFC dhe të identifikojë pamjet vizuale IR,UV, VIZ të dokumentit.
 - Software duhet të bejë validimin e integritetit të të dhënave duke krahasuar të dhënat e lexuara me njera tjetrën.
 - Software duhet të kryejë nëpërmjet kamerës identifikimin e fytyrës dhe krahasimin e saj me foton e chip-it dhe foton VIZ.
 - Software duhet të komunikojë me sistemin backend me anë të API.
 - Software duhet të komunikojë me sistemin e monitorimit me anë të API.
 - Software duhet të bëjë komunikime asynchrone dhe të sigurta duke përdorur Mutual Authentication.
 - Software duhet të dërgoj sinjale vepruese për të kontrolluar ekranin, dyert, dritat LED, kamerën, skanerin etj.
 - Software duhet të ketë mundësinë të konfigurohet me file të jashtme.

- **Software i monitorimit**

- Software i monitorimit duhet të jetë ëeb application i instaluar në server.
- Software i monitorimit duhet të përdorë komunikimet API dhe Websocket me publish-subscriber.
- Software i monitorimit do të ketë ndërfaqe UI për monitorimin e disa eGate-ve njëkohesisht.
- Software i monitorimit do të mund të përzgjedhi për monitorim vetëm eGate për të cilat i janë dhënë të drejtat përdoruesit.
- Software i monitorimit mund të dërgojë komanda tek eGate si: bllokim/hapje të një apo dy dyerve, aktivizim/çaktivizim të egates, kthim në gjëndje fillestare apo konfigurime të veçanta për eGaten.
- Software duhet të përdori gjithmonë komunikim të enkriptuar.

- **Software backend**

- Software backend duhet të jetë ëeb application i instaluar në server.
- Backend është ura lidhëse e veprimit të egate me sistemet e brendshme TIMS, Interpol, FER etj.
- Backend do të ofrojë API për klientet eGate për:
 - o Kontroll paraprak të dhënash dhe autorizim për përdorim të eGates nga udhëtari
 - o Kontroll të dhënash në bazat kriminale, interpol apo lista të ndryshme.
 - o Do të kryejë regjistrimin final të eventit në TIMS.
- Backend duhet të përdori Mutual Authentication për komunikimet me egate dhe komunikime të sigurta HTTPS, TLS, LDAPS etj në përputhje me kriteret e brendshme të sigurisë së rrjetit të policisë.

- **Sistemi do të hostohet në infrastrukturen fizike qendrore të DPPSH**

Operatori ekonomik fitues duhet të krijojë dhe një ambient test në mënyre që çdo konfigurim apo testim që mund të ndodhë në të ardhmen, të testohet paraprakisht në këtë ambient dhe me vonë ndiyshimet të realizohen në mjedisin real të punës. Kjo do të ndihmonte në qëndrueshmërinë e sistemit real të punës dhe do të shmangte problemet e gjeneruara gjatë konfigurimeve të ndryshme apo updateve që do të realizohen mbi sistemin. Gjithashtu, duhet të garantohet që sistemi operativ i çdo serveri pjesë e kësaj infrastrukture të jetë minimalisht në versionin e parafundit të lëshuar nga prodhuesit dhe me azhornimet e fundit që i përkasin versionit përkatës. Azhornimet e sistemit (update/ patch) duhet të kryhen në mënyre të vazhdueshme dhe të paraqiten në raportet mujore.

- **Qëllimi i shërbimit në këtë Component**

Qëllimi i këtij shërbimi është sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të sistemit Automatic Border Controller (ABC) dhe infrastrukturës mbështetëse përkatëse. Ky komponent do të përfshijë një gamë të plotë aktivitetesh të mirëmbajtjes teknike, auditimit të sigurisë, administrimit të rrjetit dhe infrastrukturës së virtualizuar, si dhe sigurimin e operimit të pandërprerë të pajisjeve dhe aplikacioneve të lidhura me proceset e kontrollit kufitar.

- **Auditimi i sigurisë së sistemit dhe infrastrukturës**

Në kuadër të platformës ku hostohet infrastruktura e sistemit Border Controller, operatori i mirëmbajtjes duhet të mundësojë kryerjen periodike të proceseve të auditimit të sigurisë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira në fuqi.

Auditimi i sigurisë duhet të përfshijë hapat dhe proceset e mëposhtme:

- Identifikimin dhe dokumentimin e asetëve kritike të sistemit dhe infrastrukturës IT;
- Vlerësimin e konfigurimeve të sistemit dhe zbatimin e politikave të sigurisë;
- Kontrollin e aksesit dhe verifikimin e të drejtave të përdoruesve dhe mekanizmave të autentifikimit;
- Monitorimin e log-eve dhe gjurmëve të sigurisë për identifikimin e ngjarjeve të dyshimta;
- Hartimin e raporteve të auditimit me rekomandime konkrete për përmirësime;
- Ndjekjen e planit të veprimit për adresimin e gjetjeve kritike.

- **Siguria dhe mirëmbajtja e rrjetit të sistemit Border Controller**

- Në kuadër të infrastrukturës ekzistuese të rrjetit ku operon sistemi Border Controller, operatori i mirëmbajtjes duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve të specializuara të sigurisë së rrjetit, në bashkëpunim me prodhuesit zyrtarë të pajisjeve dhe platformave ekzistuese.

-
- Ky shërbim duhet të sigurojë që infrastruktura e rrjetit të administrohet dhe mbrohet përmes produkteve të certifikuara dhe të integruara sipas standardeve më të larta të sigurisë, duke garantuar:
 - Mbrojtje efektive nga kërcënimet kibernetike;
 - Parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara;
 - Kontroll të plotë mbi aksesin dhe integritetin e trafikut të rrjetit;
 - Monitorim të vazhdueshëm dhe ndërhyrje të specializuara në rast incidentesh.
 - **Mirëmbajtja dhe administrimi i infrastrukturës së virtualizimit**
 - Operatori i mirëmbajtjes duhet të sigurojë administrimin dhe funksionimin optimal të infrastrukturës së virtualizuar në Data Center, në përputhje me standardet e avancuara të teknologjisë së informacionit.
 - Ky shërbim duhet të përfshijë:
 - Konsolidimin dhe optimizimin e burimeve serverike për eficiencë të lartë;
 - Sigurimin e High Availability (HA) dhe zgjidhjeve të Disaster Recovery (DR) për vazhdimësinë e punës;
 - Menaxhimin e sigurisë dhe kontrollin e burimeve të virtualizuara;
 - Automatizimin e proceseve të operimit dhe mirëmbajtjes së Data Center-it;
 - Monitorimin dhe optimizimin e performancës së infrastrukturës virtuale;
 - Konfigurimin e cluster-ave të hosteve, menaxhimin e burimeve dhe politikave të load balancing;
 - Automatizimin e proceseve të vendosjes së makinave virtuale, si dhe zbatimin e strategjive të backup-it dhe rikuperimit në raste emergjente;
 - Monitorimin e performancës dhe identifikimin e shkaqeve rrënjësore të problemeve përmes mjeteve të avancuara të analizës;
 - Sigurimin e ndarjes së sigurt të rrjeteve virtuale dhe kontrollit të aksesit;
 - Integrimin e infrastrukturës virtuale me komponentët e tjerë të sistemit (storage, rrjetëzim, pajisje periferike).
 - Zhvillimi, administrimi dhe operimi i mikrosërbyeve
 - Duke qenë se sistemi Border Controller dhe komponentët mbështetës funksionojnë mbi arkitekturë të mikrosërbyeve dhe container-izim operatori duhet të garantojë disponueshmërinë e kapaciteteve profesionale për administrimin e këtyre teknologjive.
 - Ky shërbim duhet të sigurojë që administrimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i moduleve të bazuara në Docker ose teknologji ekuivalente të realizohet në përputhje me standardet më të mira, duke garantuar:
 - Menaxhim të sigurt dhe efikas të container-ëve;
 - Zhvillim dhe implementim të mikrosërbyeve sipas praktikave moderne;
 - Vazhdimësi të performancës dhe stabilitetit të platformës;
 - Zbatim të politikave të sigurisë dhe automatizim të proceseve operative.

-
- Testimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i sistemit
 - Operatori duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve të testimit të automatizuar, me qëllim rritjen e cilësisë, stabilitetit dhe sigurisë së sistemit Border Controller.
 - Ky shërbim duhet të sigurojë:
 - Zbatim të metodologjive të njohura për testime të automatizuara (p.sh. Selenium, Robot Framework, etj.);
 - Detektim të hershëm të defekteve gjatë përmirësimeve ose përditësimeve;
 - Sigurimin e stabilitetit të versioneve të reja përpara vendosjes në prodhim;
 - Reduktimin e kohës së testimit dhe minimizimin e ndërprerjeve të mundshme.
 - Gjithashtu, operatori duhet të kryejë në mënyrë të vazhdueshme:
 - Analizimin e event log-eve për çdo server dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese;
 - Përditësimin periodik të sistereve operative dhe komponentëve softuerikë, duke siguruar që të jenë gjithmonë në versionet e fundit të mbështetura nga prodhuesit;
 - Instalimin dhe konfigurimin e nevojshëm të sistemeve operuese dhe softuerëve ndihmës;
 - Instalimin e agjentëve të sigurisë të aprovuar nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për cybersecurity dhe monitorim qendror;
 - Diagnostikimin dhe riparimin e problemeve teknike gjatë gjithë periudhës së ofrimit të shërbimit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Nr	Emërtimi i shërbimit	Afati i ekzekutimit
1	Intalimi i sistemit E-Gate në PKK Porti Durrës dhe PKK Port Saransë.	6 muaj nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Sipas Specifikimeve Teknike

Detyrat: Sipas Specifikimeve Teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve Teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas Specifikimeve Teknike

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi, për të gjithë komponentët hardware, software dhe licencat përkatëse të përfshira në objektin e kësaj procedure prokurimi, sipas specifikimeve teknike. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e projektimit teknik, instalimit, konfigurimit, integrit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit Automatic Border Controller (E-Gate), minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK
- b) Të paktën 3 inxhinierë IT
- c) Të paktën 1 (një) specialist për projektim arkitekture serverash, storage dhe mjedise on-premise me disponueshmëri të lartë (high availability).
- d) Të paktën 1 (një) inxhinier rrjeti i certifikuar (CCNA/CCNP ose ekuivalent), për segmentim rrjeti, firewall dhe komunikim të sigurt ndërmjet sistemeve.
